

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri dhe sek. juridike, Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K. nga fsh....., komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP nr.172-6/14 të dt.10.09.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.17.10.2015, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Visar Musa, si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.K.** nga fsh..... komuna Ferizaj, data e lindjes... në Ferizaj, nga i ati Q. dhe e ëma H. e gjinisë B., i martuar, prind i dy fëmijëve, me profesion mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 22.01.2014 rreth orës 06:35, duke lëvizur nga Ferizaj në drejtim të Gjilanit në fshatin Bibaj, komuna e Ferizajit, duke drejtuar automjetin e markës “VË Golf”, me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit, nga pakujedesia e në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushtet në rrugën me lagështi, ashtu që ka humbur kontrollin mbi veturë, del jashtë rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes dhe me pjesën e përparme të automjetit godet një shtyllë të drurit të internetit dhe një shenjë të komunikacionit me ç’rast pos dëmit mterial në veturë, lëndime të rënda trupore ka pësuar pasagjeri i tij H.D. dhe atë: ndrydhje në regjionin e krahut të djathtë si dhe thyerje e shumëfishtë në kockën e krahut të djathtë.

me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.8 lidh.me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,17,23,41,42.43,51,52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurin,

E G J Y K O N

Me të cilin e gjykon me denim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

I dëmtuari H.D. nga fsh....., komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 60.88 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.172-6/14 të dt.10.09.2016 e ka ngarkuar të pandehurin F.K. nga fsh..... komuna Ferizaj për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar gjyqësor më dt. 07.09.2016, ku i akuzuari F.K. në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ka ngarkuar akuza

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 07.09.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, ka propozuar që në këtë fazë të procedurës të mos bëhet pranimi i fajësisë pasi që në shkresë të lëndës mungon ekspertiza nga eksperti i komunikacionit dhe i ka propozuar gjykatës që të urdhëroj ekspertin e komunikacionit të bëjë ekspertizën nga lëmi i komunikacionit, ku gjykata lidhur me këtë ka urdhëruar ekspertizën nga lëmi i komunikacionit dhe pas marrjes me shkrim të mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit gjykata me datë 17.10.2016 ka caktuar shqyrtimin, ku gjykata fillimisht u ka dhënë nga një kopje të kësaj ekspertize palëve, prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit e të cilët nuk e kanë kundërshtur këtë ekspertizë.

Gjykata të pandehurit F.K., në shqyrtimin gjyqësor me dt.17.10.2016, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 325të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, vepër penale të cilën prokurori i shtetit e ka rikualifikuar dhe ashtu e pranoj si vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.1.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjeksisë ligjore e dr. M.G. i dt.14.05.2014 , si dhe mendimi i ekspertit të

komunikacionit ing. A.A. të datës 13.09.2016, si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i akuzës – prokurori i shtetit Visar Musa ka deklaruar: mbetemi në tërësi pranë aktakuzës si në përshkrimin faktik dhe kualifikimin juridik të veprës penale në të gjitha fazat e procedurës po ashtu edhe në seancën e sotme ku dhe i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë është vërtetuar në tërësi kjo aktakuzë që i vihet në barrë të pandehurit, propozojmë Gjykatës që gjatë matjes së dënimit ti ketë parasysh si rrethanat lehtësuese ashtu edhe ato rënduese ashtu që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të parapar me KPRK-në.

I akuzuari F.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: jam penduar për atë që ka ndodhur, kërkoj nga gjykata ta ketë parasysh faktin se i dëmtuari me rastin e këtij aksidenti kam qenë me kolegun tim të punës duke shkuar në punë ku ka ndodhur aksidenti, unë menjëherë pas aksidentit jam interesuar vazhdimisht për kolegun tim duke pasur parasysh faktin se jam i martuar dhe prind i dy fëmijëve, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, andaj mbi bazën e kësaj të më shqiptoj një dënim sa më të butë .

Analizuar nga aspekti juridik në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 1 të KPRK, të kryer në ditën, vendi, kohën, mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës “VË Golf”, me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit, nga pakujedesia e në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushtet në rrugën me lagështi, ashtu që ka hmbur kontrollin mbi veturë, del jashtë rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes dhe me pjesën e përparme të automjetit godet një shtyllë të drurit të internetit dhe një shenjë të komunikacionit me ç’rast pos dëmit mterial në veturë, lëndime të rënda trupore ka pësuar pasagjeri i tij H.D. dhe atë: ndrydhje në regjionin e krahut të djathtë si dhe thyerje e shumëfishtë në kockën e krahut të djathtë.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nen. 73 të KPRK-së, si rethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë në mënyrë të sinqertë në të gjitha fazat e procedures penale si në shqyrtimin fillestar e poashtu edhe në shqyrtimin kryesor duke shprehur pendimin për veprën penale, keqardhjen për aksidentin e shkaktuar, se të dëmtuarit nuk ju kan bashkangjitur ndjekjes penale, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rezikshmerinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar denim të kushtëzuar si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një denim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rethanave të kryerjes së vepres penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPK-së.

I dëmtuari H.D. nga fsh....., komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Konform nenit 450 të KPPRK-së, i pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej 60.88 € për ekspertizën e komunikacionit si dhe ekspertizën mjeko ligjore si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcnimin e përbarimit me dhunë

Nga arsyet e sipër cekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.992/14, dt.17.10.2016**

Sekretarja Juridike ,
Drita Ujupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.